



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.135 dt.30.10.2001

**PER
MIRATIMIN E DISA PROJEKTEVE NE FUSHEN E INFRASTRUKTURES SE
LEHTE DHE TE RENDE NE QYTETIN E TIRANES**

Në mbështetje të nenit 32, gërma “dh” të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor”, Ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal në Republikën e Shqipërisë”, neni Nr.19 të Ligjit Nr.7971 dt.26.07.1995 “Për prokurimin publik”, neni 8, pika 5 të Ligjit Nr.8767 dt.05.04.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit 7971 dt.26.07.1995 “Për prokurimin publik” Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.22 dt.13.02.2001 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2001 për Bashkinë Tiranë”, në bazë të projekteve dhe relacionit të paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë projektin “Sistemim, asfaltim, ndriçim pedonal, rikonstruksion trotuarësh dhe zgjerim i Bulevardit “Zhan D’Ark” dhe “Bajram Curri”, për segmentin nga Rr. Elbasanit deri tek kryqëzimi me Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit në shumën prej 66.000.000 lekë sipas preventivit bashkëngjitur

2. Të finançohet projekti sipas pikës 1 të këtij vendimi, në shumën prej 20.000.000 lekësh për vitin 2001 dhe në shumën prej 46.000.000 lekësh për vitin 2002 sipas projektit
3. Të miratojë fondin, për shtesën e kontratës për projektin “Sistemim, asfaltim, rehabilitim i ujësjellësit, kanalizim, ndriçimi dhe rregullimi i trotuarëve në segmentin e Rr. Bajram Curri” në shumën prej 6.000.000 lekësh sipas projektit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike. Kontrata do të lidhet pas miratimit përkatës nga Agjensia e Prokurimit Publik
4. Të miratojë fondin prej 10.000.000 lekësh për fazën e parë të Projektit “Rehabilitimi i pjesshëm, pastrim kimik, ndriçimi estetik në Universitetin Politeknik të Tiranës, Ministrisë së Kulturës, Rinis dhe Sporteve, Godinës së Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit Popullor” për Drejtorin e Përgjithshme Nr.1 të Qytetit
5. Fondi sipas pikave 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi të përballohet sipas tabelës bashkangjitur
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

